

## DOKUMENTACIONI PER KERKIMIN E GRADES SHKENCORE

### “DOKTOR”

(Përmbajtja e dosjes)

1. Kërkesa me shkrim për regjistrim në Programin e Studimeve të Doktoratës, që përfshin specialitetin e dëshiruar dhe Departamentin të cilit i drejtohet.
2. Çertifikatë lindje ose fotokopje e noterizuar e kartës së identitetit.
3. Diploma e shkollës së lartë (Bachelor + Master Shkencor) dhe lista e notave, origjinale ose të noterizuara.
4. Vërtetimi i notave të ciklit teorik të doktoratës ose Diploma ekuivalente me këtë cikël.
5. Curriculum vitae dhe bibliografia e punimeve.
6. Fotokopje të noterizuara të dëshmive të kualifikimeve të ndryshme.
7. Dy rekomandime.
8. Propozimi i Departamentit për temën e disertacionit dhe udhëheqësin shkencor.
9. Deklaratë pranimi nga udhëheqësi, ku specifikohet fusha e kërkimit dhe propozimi i temës së disertacionit.
10. Vendimi i Këshillit të Profesorëve për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës.
11. Vendimi i Këshillit të Profesorëve për miratimin e temës së disertacionit dhe udhëheqësit shkencor.
12. Vërtetimi i regjistrimit në Programin e Studimeve të Doktoratës
13. Programi i punës për përgatitjen e disertacionit i ndarë në vite mësimore, i hartuar nga udhëheqësi dhe miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit.
14. Raportet e realizimit të programit në fund të çdo viti akademik, të paraqitura nga udhëheqësi dhe të nënshkruara nga Përgjegjësi i Departamentit.
15. Vërtetimi nga financa e Fakultetit për shlyerjen e detyrimeve financiare të Programit të Studimeve të Doktoratës.
16. Realizimi i programit të doktoratës në trajtë të përmbledhur sipas modelit përkatës.
17. Bibliografia e punimeve të realizuara gjatë procesit të përgatitjes së disertacionit të doktoratës. çdo punim, referim dhe artikuj shkencor, minimalisht duhet të paraqitet me:
  - fotokopjen e faqes së parë të revistës/proceedings ku është botuar,
  - fotokopjen e faqes së përmbajtjes së lëndës të revistës/proceedings ku pasqyrohet punimi dhe fotokopjen e faqes së bordit editorial të revistës.
  - fotokopje e faqes së parë të punimit.
18. Disertacioni i doktoratës në format letër.
19. Përmbledhja e disertacionit e miratuar nga udhëheqësi në format letër dhe format elektronik (në shqip dhe anglisht, në *format pdf dhe e kopjuar në CD*).
20. Kërkesë e kandidatit për dhënie leje mbrojtjeje, drejtuar Këshillit të Profesorëve të Fakultetit.
21. Mendim i udhëheqësit, përfshirë lejen e tij për mbrojtje.
22. Mendim i Departamentit për dhënie leje mbrojtjeje dhe propozimi i jurisë.
23. Çertifikata e gjuhës së huaj sipas Vendimit Nr.1, date 28.01.2016 të Senatit të UPT.

Shënim: Dosja e plotësuar duhet të shoqërohet me inventarin e saj (përmbajtjen)